



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:080818

Datë: 07.02.2023

Numri i dokumentit: 03949649

A.nr.1137/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit S.A., nga Gjilani, përfaqësuar nga avokat E.A., Kamenicë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me bazën juridike: anulim vendimi, në shqyrtimin kryesor publik, me datë 07.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit S.A., nga Gjilani dhe **ANULOHET** vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 16.06.2020 dhe vendimi i datës 19.03.2018, paditësit i **NJIHET** e drejta në kompensimin retroaktiv për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë nga data 29.12.2017 deri më datë 07.02.2023, kurse nga data 08.02.2023-07.02.2028 i njihet e drejta në vazhdim për kompensimin për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj në mënyrë retroaktive pagesat mujore të papaguara në emër të kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë sipas diferencës në mes të pensionit paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë dhe pensionit kontibutpagues të moshës nga data 29.12.2017-07.02.2023, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, kurse nga data 08.02.2023-07.02.2028 kompensimi bëhet në baza mujore për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë në shumën e cila aplikohet për këtë lloj kompensimi, si kompensim më i favorshëm për paditësin.
- III.** Pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën II të dispozitivit paditësi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.
- IV.** Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Arsyetimi

Shqyrtimi gjyqësor i datës 07.02.2023 është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative në mungesë të palës së paditur e ftuar me ftesë të rregullt gjyqësore.

Në kuptim të nenit 368 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke pasur parasysh edhe deklarin e përfaqësuesit të palës paditëse se nuk e ka të nevojshëm prezencën e ekspertëve mjekësor, gjykata ka mbajtur seancën.

Paditësi në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar të aprovohet kërkesëpadija e paditësit, duke deklaruar mes tjerash se në tërësi mbetem pranë padisë dhe kërkesë padisë së paditësit për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë. Tani paditësi është në gjendje krejtësisht i pa lëvizshëm në shtrat dhe i varur nga kujdesi i personave të tjerë për 24 orë në ditë sipas diagnozës demante alzhaimit me çrregullim kronik apo i vazhdueshëm të proceseve motorike –mendore, pra paditësi konsideroj se plotëson të gjitha kushtet ligjore në bazë të raporteve mjekësore të cilat gjinden në shkresa të lëndës se është person krejtësisht i pas aftë për jetë të pavarur dhe është konstatuar se është e domosdoshme për kujdesja ndaj personi tjetër për ushqim pastrim, veshmbathje si dhe të gjitha nevojat tjera shëndetësore. I propozojmë gjykatës që të caktohet ekspertizë mjekësore nga mjeket ekspert lidhur me gjendjen shëndetësore të paditësit. Kërkohet kompensimi si pasoj e ekzekutimit të vendimit të kundërligjshëm dhe atë nga data 29.12.2017 si datë e parashtrimit të kërkesës, kompensimi të bëhet në mënyrë retroaktive dhe atë diferenca në mes të pensionit kontribut-pagues të moshës (të cilën paditësi e ka të aprovuar nga data 16.07.2012), dhe pensionit paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë deri në datën e aktgjykimit. Kurse nga data e aktgjykimit kërkohet ti njihet e drejta dhe kompensimi sipas pensionit të përcaktuar për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, si pension më i favorshëm se ai kontribut-pagues. Kërkohet të anulohet vendimi i shkallës së parë dhe i shkallës së dytë.

Përfaqësueses të të paditurës Avokatura Shtetërore, i është dërguar aktvendimi për përgjigje në padi A.nr.1137/20 të dt.08.11.2021 dhe 22.12.2021,të cilat vendime i ka pranuar në mënyrë të rregullt, mirëpo e njëjta pranë Gjykatës nuk ka dorëzuar përgjigje në padi. Po ashtu ekspertizën e datës 22.11.2022, e ka pranuar me datë 22.11.2022 dhe e njëjta nuk është kundërshtuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 07.02.2023 ka administruar provat si: vendim i dt.16.06.2020, nga MPMS, fletë Lëshimi nga Spitali Rajonal Gjilan, Dt. e pranimi 19.06.2014, dt. e lëshimit 23.06.2014, kontratë për njohjen e kujdestarit personal për persona statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik,i dt.21.05.2018,vërtetim i nënshkrimit PPR.Nr.2212/2017, dt.28.12.2017, aktgjykimi A.nr.1324/18, i dt.24.10.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, vendim i dt.15.06.2020, nga MPMS, raport nga Konsulta Mjekësore, dt. 29.06.2020, kopje të fotografive, raport i dt.08.07.2021, 23.06.2014, 09.01.2013, 15.10.2019, 10.03.2021, 29.06.2020, 25.06.2019, 10.04.2012, vendim i dt.19.03.2018, vendim i dt.10.05.2018, ekspertizë mjekësore e dt.22.11.2022.

Në kuptim të nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet se : *‘1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.*

Me aktgjykimin A.nr..1324/2018 datë 24.10.2019, anulohet vendimi i datës 10.05.2018 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

Me vendimin e datës 16.06.2020 të të paditurës këtu paditësit i është refuzuar ankesa për kompensimin për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë.

I pa kënaqur me vendimin e lartcekur paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë duke e kundërshtuar të njëjtin.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar.

Me qëllim të vendosjes meritorë në këtë çështje juridike administrative kjo gjykate duke u bazuar në neni 43.3 të Ligjit për Konflikte Administrative dhe për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë, për të cilën ekspertizë është caktuar që ta bëjë QKUK. Me aktin përcjellës të datës 22.11.2022 është dorëzuar ekspertiza në përbërje të ekspertëve Dr.Sh.D.- neurokirurg, Dr.B.M-neurolog dhe Dr.T.O.V.-fiziatër, në të cilën ekspertizë referohet konstatimi se paditësi ka diagnozat *demntia alzheimer, teraparesis spastica, dysphasio motorica, syndroma anxioso-depressivum, hipertensio arterialis, vesica neurogenes, staus post stenting PCI pp.I.M* dhe konstatimi se *për shkak të sëmundjes ose dëmtimit të strukturës të sistemit nervor qendror apo periferik pacienti ka çrregullim psiko-motorik kronik përcjellur me çrregullime të kujtesës, ndryshim të personalitetit dhe racionalitetit si dhe dobësi e të katër ekstremiteteve në shkallë 2/5 në ekstremitete e sipërme dhe 1/5 ekstremitetet e poshtë si dhe pamundësi në të folur, në një periudhë kohore që prej viti 2014. Mendimi i përbashkët është se pacienti ka të humbur përfundimisht aftësinë e lëvizjes së ekstremiteteve, paaftësia e kufizuar si e tillë është definitive dhe e përhershme, duhet të ketë kujdestar personal dhe hyn në grupin e tetraplegjikëve të kategorisë së parë.*

Nga vlerësimi dhe mendimi i komisionit mjekësor të QKUK-së në ekspertizës mjekësore se paditësi hyn në grupin e personave tetraplegjik të grupit të parë, që kjo gjendje është qysh para viti 2014, po ashtu Gjykata konstaton se diagnozat e referuara në ekspertizë sipas raporteve mjekësore konstatohen referuar periudhës së viti 2014, andaj paditësi plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë ku gjykata kishte parasysh se me Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik neni 3 paragrafi 1 përcaktohet :

” 1.1. Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmëtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme”, kurse neni 7 paragrafi 2 i po të njëjti Ligj përcakton “2. Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni”, dhe po ashtu neni 8 paragrafi 1 të po të njëjtit Ligj përcaktohet se :

“Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”,

Si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr. 07/2017 për Përbërjen, Funksionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ku përcaktohet: *“Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t’i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik”*

Prandaj gjykata konstaton se në bazë të mendimit të dhënë nga Komisioni Mjekësor i QKUK-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, vërtetohet se paditësi i plotëson kushtet për njohjen e të drejtës në kompensimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, i përcaktuar nga neni 3 dhe neni 7 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe mbi këto arsye edhe vendimin kontestues e konstaton si jo të drejtë dhe jo të ligjshëm.

Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me njohjen e të drejtës dhe kompensimin si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi gjykata kishte parasysh datën e kërkesës dhe parashtrimin e saj.

Lidhur me periudhën e vendosjes si në pikën II të dispozitivit u vendos në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ku përcaktohet :’*E drejta në kompensim të përfituesve të këtij ligji, si dhe të kujdestarit personal të tyre, realizohet nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”*. Si dhe në kuptim të nenit 9 paragrafi 1 të Rregullore (QRK) Nr.

07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ku përcaktohet: “Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t’i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, po ashtu në kuptim të periudhës së rivlerësimit.

Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv Gjykata kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. *kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.*”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. *Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore*”. Lartësia e shumës së kompensimit u vendos në kuptim të nenit 7.1 të Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Lidhur me shumën e kompensimit Gjykata kishte parasysh *diferencën e kompensimit të këtu paditësit për personat paraplegjik dhe teraplegjik të grupit të parë në raport me kompensimin për pension kontribut pagues të moshës, ku sipas vendimit të datës 15.06.2020 paditësit i është miratuar kërkesa për pension kontributpagues të moshës nga data 17.07.2012.*

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 7 Ligji Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, është vërtetuar se paditësi i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43.3 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
A.nr. 1137/20- datë 27.02.2023

Sekretare juridike
Nazife Sheholli

G j y q t a r e
Liridona Ajeti Kajtazi

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.